

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË “Hidropower Elektrik” shpk

Sot, më datë 27 Qershor 2018, në selinë e shoqërisë “**Hidropower Elektrik**” shpk (NUIS K92115027K) ndodhur në Tiranë, Rruga "Frosina Plaku", banesa nr.7 (prane 21 dhjetorit) u mbledh Asambleja e Përgjithshme e ortakëve të kësaj shoqërie.

Në përputhje me të dhënat e regjistrimit tregtar (sipas ekstrakteve zyrtare) ortakë të kësaj shoqërie figurojnë:

- Shoqëria “**Wondervolt 2018**” shpk (NUIS L81423001S) e cila zotëron një kuotë **që përfaqëson 65,34%** (gjashtëdhjetë e pesë pjesë tridhjetë e katër) të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe përfaqësohet në këtë mbledhje nga administratori i saj **Z. Naimir Kurti** i cili edhe drejton mbledhjen.
- Shoqëria “**LNK**” shpk (NUIS K02003004P) e cila zotëron një kuotë **që përfaqëson 34.66%** (tridhjetë e katër pjesë gjashtëdhjetë e gjashtë) të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe përfaqësohet në këtë mbledhje nga administratori i saj **Z. Taip Kurti**.

Pas kryerjes së njoftimeve përkatëse me telefon, me shkrim dhe me afishim në selinë e shoqërisë u paraqitën për të marrë pjesë në mbledhje ortakët të cilët së bashku zotërojnë kuota që përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar. Në bazë të statutit të ortakëve “LNK” shpk dhe “Wondervolt 2018” shpk si dhe të të dhënave që figurojnë në regjistrin tregtar rezulton se përfaqësuesit e ortakëve zotërojnë kompetenca të pakufizuara vendimmarrjeje në këtë Asamble të Përgjithshme.

Në mbledhje merr pjesë edhe administratori i shoqërisë “Hidropower Elektrik” shpk i cili harton këtë vendim në përputhje me vullnetin e Asamblesë së Përgjithshme.

Rendi i ditës:

- 1- Revokimi i pikës 2 (dy) të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme datë 10.06.2016. Në vend të kësaj pike vendoset që fitimi prej 26.027.033 leke të mbuloje humbjen e vitit 2015 në shumen 3.538.669 leke. Ndërsa, pjesa e mbetur prej 22.488.364 leke të perdoret për zmadhimin e kapitalit.
- 2- Revokimi i pikës 2 (dy) të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të datës 26.06.2018, në vend të kësaj pike vendoset që fitimi i vitit 2017 të perdoret si me poshte:
 - Te mbuloje humbjen e vitit 2016 në shumen 10.361.288 leke.
 - Te Zmadhoje Kapitalin e shoqërisë “Hidropower Elektrik” shpk me shumen prej 63.354.119 leke.
- 3- Fillimi i procedurës për rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë “Hidropower Elektrik” shpk nepermjet rritjes së vlerës së kuotave. Zmadhimi do të kryhet nepermjet perfshirjes në kapitalin fillestar të fitimit të pa shperndare gjendje me 31.12.2017 në shumen 85.842.483 leke dhe nga perfshirja në kapital e rezervës ligjore dhe rezervave të tjera në shumen 325.136 leke.
- 4- Emerimi i znj Ana Osmani audituese ligjore, mbajtese e licenses nr. 85, date 07.12.2000, leshuar nga IEKA, për vleresimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë.
- 5- Ngarkohet administratori me zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim, së bashku me pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Administratori ose personi i autorizuar prej tij.

Asambleja e Përgjithshme pasi shqyrtoi ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”; me unanimitet,

Vendosi:

- 1- Revokimi i pikës 2 (dy) të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme datë 10.06.2016. Në vend të kësaj pike vendoset që fitimi prej 26.027.033 leke të mbuloje humbjen e vitit 2015 në shumen 3.538.669 leke. Ndërsa, pjesa e mbetur prej 22.488.364 leke të perdoret për zmadhimin e kapitalit.
- 2- Revokimi i pikës 2 (dy) të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të datës 26.06.2018, në vend të kësaj pike vendoset që fitimi i vitit 2017 të perdoret si me poshte:
 - Te mbuloje humbjen e vitit 2016 në shumen 10.361.288 leke.
 - Te Zmadhoje Kapitalin e shoqërisë “Hidropower Elektrik” shpk me shumen prej 63.354.119 leke.
- 3- Fillimi i procedurës për rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë “Hidropower Elektrik” shpk nepermjet rritjes së vlerës së kuotave. Zmadhimi do të kryhet nepermjet perfshirjes në kapitalin fillestar të fitimit të pa shperndare gjendje me 31.12.2017 në shumen 85.842.483 leke dhe nga perfshirja në kapital e rezervës ligjore dhe rezervave të tjera në shumen 325.136 leke.

4- Emerimi i znj Ana Osmani audituese ligjore, mbajtese e licenses nr. 85, date 07.12.2000, leshuar nga IEKA, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit te shoqerise.

5- Ngarkohet administratori me zbatimin e ketij vendimi. Ky vendim, se bashku me pasqyrat financiare te audituara dhe raportin e auditimit do te regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Administratori ose personi i autorizuar prej tij.


6- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U bë në katër kopje. Një ruhet nga shoqëria, një i jepet përfaqësuesit të ortakut "LNK" shpk Z. Taip Kurti ndërsa nga një kopje mbahet në dispozicion të shoqërisë "Energjia Ekologjike" shpk dhe "Wondervolt 2018" shpk.

Ortaku:

**Shoqëria "LNK" shpk
Taip Kurti**

(emër, mbiemër, vulë e shoqërisë "LNK" shpk)



**Shoqëria "Wondervolt 2018" shpk
Naimir Kurti**

(emër, mbiemër, vulë e shoqërisë "Wondervolt 2018" shpk)



**Vula e Shoqërisë
Administratori
Enkelev Kurti**



VENDIM
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË “Hidropower Elektrik” shpk

Sot, më datë 04 Korrik 2018, në selinë e shoqërisë “**Hidropower Elektrik**” shpk (NUIS K92115027K) ndodhur në Tiranë, Rruga "Frosina Plaku", banesa nr.7 (prane 21 dhjetorit) u mbledh Asambleja e Përgjithshme e ortakëve të kësaj shoqërie.

Në përputhje me të dhënat e regjistrimit tregtar (sipas ekstrakteve zyrtare) ortakët të kësaj shoqërie figurojnë:

- Shoqëria “**Wondervolt 2018**” shpk (NUIS L81423001S) e cila zotëron një kuotë që përfaqëson **65,34%** (gjashtëdhjetë e pesë pjesë tridhjetë e katër) të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe përfaqësohet në këtë mbledhje nga administratori i saj **Z. Naimir Kurti** i cili edhe drejton mbledhjen.
- Shoqëria “**LNK**” shpk (NUIS K02003004P) e cila zotëron një kuotë që përfaqëson **34.66%** (tridhjetë e katër pjesë gjashtëdhjetë e gjashtë) të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe përfaqësohet në këtë mbledhje nga administratori i saj **Z. Taip Kurti**.

Pas kryerjes së njoftimeve përkatëse me telefon, me shkrim dhe me afishim në selinë e shoqërisë u paraqitën për të marrë pjesë në mbledhje ortakët të cilët së bashku zotërojnë kuota që përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar. Në bazë të statutit të ortakëve “LNK” shpk dhe “Wondervolt 2018” shpk si dhe të të dhënave që figurojnë në regjistrimin tregtar rezulton se përfaqësuesit e ortakëve zotërojnë kompetenca të pakufizuara vendimmarrjeje në këtë Asamble të Përgjithshme.

Në mbledhje merr pjesë edhe administratori i shoqërisë “Hidropower Elektrik” shpk i cili harton këtë vendim në përputhje me vullnetin e Asamblesë së Përgjithshme.

Rendi i ditës:

- 1- Miratimi i raportit të përgatitur nga Audituesja Ligjore Ana Osmani për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nëpërmjet përfshirjes në kapitalin themeltar të fitimit të vitit 2017, fitimit të mbartur dhe rezervat ligjore dhe rezervat e tjera gjëndje në datën 31.12.2017.
- 2- Rritja e kapitalit themeltar të shoqërisë duke përfshirë fitimin e vitit 2017, fitimin e mbartur, rezervat ligjore dhe rezervat e tjera gjëndje në datën 31.12.2017 në vlerën totale prej 86,167,619 Lekë.
- 3- Kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 89.341.306 lekë.
- 4- Pjesëmarrja e ortakut “Wondervolt 2018” shpk mbetet e pandryshuar dhe ky ortak do të zotërojë një kuotë që përfaqëson 65,34% të kapitalit themeltar të shoqërisë, kuotë e cila është e barabartë me vlerën 58.375.609 lekë.
- 5- Ortaku “LNK” shpk do të zotërojë një kuotë që përfaqëson 34.66% të kapitalit themeltar të shoqërisë, kuotë e cila është e barabartë me vlerën 30.965.697 lekë.
- 6- Ngarkohet administratori me zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim, do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme pasi shqyrtoi ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”; pasi shqyrtoi raportin e datës 28.06.2018 të Auditueses Ligjore Ana Osmani; me unanimitet,

Vendosi:

- 1- Miratimin e rendit të ditës.
- 2- Miratimin e raportit të përgatitur nga Audituesja Ligjore Ana Osmani për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nëpërmjet përfshirjes në kapitalin themeltar të fitimit të vitit 2017, fitimit të mbartur dhe , rezervat ligjore dhe rezervat e tjera gjëndje në datën 31.12.2017.
- 3- Rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë duke përfshirë fitimin e vitit 2017, fitimin e mbartur dhe rezervat ligjore dhe rezervat e tjera gjëndje në datën 31.12.2017 në vlerën totale prej 86,167,619 Lekë.
- 4- Kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 89.341.306 lekë.
- 5- Pjesëmarrja e ortakut “Wondervolt 2018” shpk mbetet e pandryshuar dhe ky ortak do të zotërojë një kuotë që përfaqëson 65,34% të kapitalit themeltar të shoqërisë, kuotë e cila është e barabartë me vlerën 58.375.609 lekë.
- 6- Ortaku “LNK” shpk do të zotërojë një kuotë që përfaqëson 34.66% të kapitalit themeltar të shoqërisë, kuotë e cila është e barabartë me vlerën 30.965.697 lekë.

7- Ngarkohet administratori me zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim, do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

U bë në katër kopje. Një ruhet nga shoqëria, një i jepet përfaqësuesit të ortakut "LNK" shpk Z. Taip Kurti ndërsa nga një kopje mbahet në dispozicion të shoqërisë "Energjia Ekologjike" shpk dhe "Wondervolt 2018" shpk.

Ortaku:

Shoqëria "LNK" shpk

Shoqërisë

Taip Kurti

Administratori

(emër, mbiemër, vulë e shoqërisë "LNK" shpk)



Shoqëria "Wondervolt 2018" shpk

Naimir Kurti

(emër, mbiemër, vulë e shoqërisë "Wondervolt 2018" shpk)



Vula e

Enkelev Kurti

